

POP 5

1

Eshtë dënuar dhe dëbuar nga Britania, kush është shqiptari që 'gucoi' të kthehej? Mediat britanike: Simbol i abuzimit të sistemit

2

Në Shqipëri akuzohet për rrëmbimin e Jan Pengja, lindet me kushin nga burgu në Ekzodur Dritan shqiptar që përmbysi Europën me drogë?!

3

Sulmoi shtetin dhe institucionet, nuk ecapast Sulmoi PD e përjashtuar! Brapc: Vendimi për Berishën, hipokrit, por standard

4

Vdekja e 3-vjeçarit, letra që edukatorja i dërgoi Gjykatës pasi nuk ishte në seancë: Jam shumë e ngarkuar

5

Transplanti i parë në botë, 57-vjeçari në Amerikë merr sëmën e derri të modifikuar gjenetikisht

Kronikë


Atentat në Fushë Krujë, qëllohet me breshëri kallashnikovi në drejtim të një makine, plagosen 2 persona! Kush është ish-polic i që i shpëtoi plumbave, në 2016 tentuan ta vrasin me eksploziv

Një tjetër atentat me armë është shënuar në fshatin Larushk në Fushë Krujë, ku si pasojë e sulmit ka mbetur i plagosur ish efektiv i policisë Gentian Bejtja. Ai u qëllua duke lëvizur me mjetin e tij, ku si pasojë e humbjes së kontrollit u aksidentua edhe Klodian Stafuka. Kjo është hera e dytë që ndaj 41 vjeçarit behet atentat

- I shpëtoi atentatit, Klodian Stafuka shfaqet jashtë spitalit të Traumës, merret në pyetje nga policia
- 'Është qëlluar nga pas', kushëri i Gentjan Bejtjas tregon si i ka shpëtuar atentatit: Ka bërë manovra me makinën




RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



FUSHË-KRUJË- Një atentat me armë është shënuar mbrëmjen e kësaj të diele në fshatin Larushk në Fushë Krujë. Ngjarja ka ndodhur pranë një karburanti, ku si pasojë e sulmit ka mbetur i plagosur në krah, ish efektiv i policisë Gentian Bejtja.

Ndaj 41 vjeçarit është qëlluar me armë, sapo ai kishte furnizuar mjetin me karburant dhe ishte në lëvizje. Për pasojë Gentian Bejtja ka humbur kontrollin dhe mjeti ka dalë nga rruga. I plagosur nga aksidenti ka mbetur edhe Klodian Stafuka, i cili ndodhej në mjet me Gentian Bejtjan.



LEXO EDHE:
Durrës/ Organizonin lojëra fati, arrestohen 3 të huaj, shpallet në kërkim një grua! Sekuestrohen 93 kompjuterë dhe 8 tavolina

Të dy të plagosurit, njëri nga plumbat dhe tjetri gjatë daljes së mjetit jashtë rrugës, janë paraqitur në spitalin e Traumës në Tiranë ku kanë marrë ndihmën mjekësore, ndërsa ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Skënder Bejtja tha për Report Tv, se kushëri i tij Gentian Bejtja nuk i ka parë atentatorët, pasi është qëlluar nga pas. Kjo është hera e dytë që **Gentjan Bejtjas** i bëhet atentat, ndërsa është një person me precedent të mëparshëm penal. Në vitin 2016 ai i ka shpëtuar një atentati me telekomandë. Bejtja ishte personi që së bashku me Enver Stafukën vodhën veturën e përdorur në vrasjen e kryekomisar Dritan Lamajt në vitin 2013.

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 20:37

I shpëtoi atentatit, Klodian Stafuka shfaqet jashtë spitalit të Traumës, merret në pyetje nga policia



Klodian Stafuka, i cili mbeti i plagosur nga atentati mbrëmjen e sotme në Larushk të Fushë-Krujës, bashkë me Gentjan Bejtjan, është filmuar në spitalin e Traumës. Stafuka siç shihet është në gjendje të mirë shëndetësore, ndërsa është marrë në pyetje nga policia në lidhje me ngjarjen.